

DUKURI TË REJA NË LETËRSINË E PAS VITEVE '90-TË (KËNDVËSHTRIMI I POEZISË) NEW PHENOMEN IN THE ALBANIEN LITERATURE OF' 90-S

EDLIRA CERKEZI

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Departamenti i gjuhës dhe letersise shqip, Vlorë, SHQIPËRI
E-mail: edlira_cerk@yahoo.com

AKTET VI, 4: 395 - 399, 2013

PERMBLEDHJE

Është pranuar tashmë nga studiuesit, se vitet e fundit në letërsinë shqipe janë vënë re shenja të dukshme të një hopi cilësor, tiparet e të cilit formulohen duke iu bindur ligjësisë artistike e estetike. Kur flasim për letërsinë e post-diktaturës, jemi të detyruar të përcaktojmë ndryshimin politik në Shqipërinë e vitit 1992. Artikulli shtron në diskutim situatën krijuese shqiptare të fundit të shekullit të 20 – të. Kjo atmosferë letrare shqiptare përimitohet sipas tipareve të prodhimit letrar të kësaj kohe, kur në fondin e letërsisë shqipe krijojnë pesë grupe krijuesish. Përmes këtyre pesë tipave të letërsisë shqiptare përpiqemi të bëjmë edhe një lloj tipizimi të kësaj letërsie. Ky tipizim na shërben si pikënisje e domosdoshme për të arritur qëllimin e studimit të poezisë shqipe që po lindte në vitet '90 – të të shekullit të kaluar. Kjo poezi që po krijohet, kryesisht identifikohet me krijuesit e rinj, të cilët bënin hapat e parë në krijimtarinë poetike. Ky prez i ri krijuesish krahas afirmimit të tyre si krijues u bënë edhe bartës të tendencave të reja, të thyerjes së traditës së realizmit socialist dhe të kthesës së rëndësishme që shënoi me orientimin e poezisë shqipe drejt tendencave të reja e të përfshirjes së saj në rrjedhat e përgjithshme krijuese evropiane e botërore.

Fjalët çelës: ndryshim politik; ravijizim; kuptime poetologjike; ingranim; proces letrar.

SUMMARY

It is now accepted by scholars, that in recent years in Albanian literature are noticed obvious signs of a qualitative steep, features of which are formulated by obeying the law of artistic and aesthetic. When we talk about post-dictator literature, are required to define political changes in Albania in 1992. Poetry in the recent years is strictly compared with remarkable modeling for a rapid design of new features, collective pathos feeling occurring in their own themes and description that describe not just daily, but from the depth of human exploitation. Here we will emphasize qualitative achievement in terms of high level communication and messaging effects through poetic images and symbolizing the metaphors in contexts. Poetic experience of these authors is known for a high sensitivity of perceptual and receptive elements in which we find the prosperous of individual psychic life, but also qualitative social national life, too. Social level and artistic abstracts and the large lexical wealth is another lexical special feature of this poem. In conclusion we would underline some essential features of this poetry in some modeled authors as such, well-known ones or not who may need more cultivated readers and researcher of literary phenomena which are the best evidence of new positive qualities.

Key words: political changes; underline; poetic meaning; gearings; literary process.

1. Hyrje

Në fund te viteve '80 të shekullit XX, sidomos në vitet e para të viteve '90, në letërsinë tonë vihet re dëshira dhe aspirata e një grupi letrarësh dhe artistësh, të të gjitha fushave dhe gjinive, për t'u çliruar nga rregullat e ngurta estetike të

socrealizmit, që deri atëhere kishte statusin e metodës zyrtare dhe krijimin letrar ta perceptonin ndryshe. Kjo dëshirë dhe aspiratë e ligjshme dhe evolucioniste u pa se mund të bëhej realitet pas përmbyesjes përfundimtare të komunizmit dhe kthimit të shqiptarëve tek liria.

Liria politike e viteve '90 u shoqërua natyrshëm me lirinë ekonomike, ideologjike, fetare e estetike. Kështu në këtë reaksion zinxhir lirish, u krijuan kushte tepër të favorshme për t'u larguar përfundimisht nga tipi i shkrimit të detyruar letrar (ideologjik socrealist) dhe fillimin e një shkrimi të ri, të lirë, të paparagjykuar, të pacensuruar dhe të parrezikuar nga asnjë faktor.

2. Zëvendësimi i konvencave letrare

Në këtë kontekst situata dhe mjedisi letrar karakterizoheshin nga pluralizmi i qëndrimeve politike dhe estetike. Filluan të formohen gjithfarë rrymash, mendimesh e drejtimesh, të cilat çuan në një konfiguracion të larmishëm krijuesish, veprash e prirjesh letrare. Ashtu siç u bë i domosdoshëm, tridhjetë vjet më parë, zëvendësimi i konvencioneve të vjetra të letërsisë së viteve '50 të shek. XX natyrshëm u pa qartë, se, njëlloj si atëherë, edhe tani, kishte ardhur koha për aplikimin e konvencioneve të reja, për shkak se normat estetike të letërsisë paraardhëse ishin konsumuar e vjetëruar, madje ishin kthyer në një pengesë serioze për të.

Për këtë situatë letrare e krijuese prof. Floresha Dado mendon: "Është e natyrshme të pranojmë se marrëdhëniet e letërsisë së viteve '90 me traditën letrare përfshijnë përgjithësisht një konflikt, një pozicion kundërshtues. Kjo lidhet me faktin se përmes formave të reja dhe efekteve estetiko-emocionale, synohet një liri tjetër në përmbajtje dhe në iluzionin artistik të raportit midis realitetit tonë njerëzor dhe mënyrave konvencionale të përfytyrimit të tij. Konceptimi i reales me imagjinaren, prirja e pjesës dërmuese të shkrimtarëve, sidomos e romancierëve, është më shumë reagim ndaj traditës, sesa ndikim prej formave të saj. Tek autorë të rinj, ky reagim shfaqet më agresiv deri në ekstravaganca të strukturave artistike /.../. Duket sikur letërsia iu kundërvu vetvetes, por në thelb priret të dëshmojë, në struktura të reja artistike, dallimin në vështrimin konvencional të realitetit" (Dado 2007: 148).

Në këtë përpjekje u ingranua procesi letrar post-diktatorial, që të realizonte gjithsesi shkëputjen nga dogma që përshkon letërsinë e realizmit

socialist. Janë kijuesit e rinj që marrin në sy të realizojnë këtë shkëputje me qëllim përfundimtar konturimin e tipareve të brishta për momentin e një hopi cilësor së paku në drejtim të ndarjes një herë e mirë të letërsisë nga dogma dhe të kthimit të saj në amëz të njeriut të botës introspektive të personazheve, të ambientit, ngjarjes, shtresave emocionale.

"Hopi cilësor", merret me mend dhe pranohet se është një fenomen i madhërishtë dhe i vlershëm në letërsinë e një vendi; ai kërkon kohë, emra të mëdhenj, vepra të vërteta letrare të qëndueshme – sintezë e tabanit letrar psikologjik kombëtar të një populli. Por emrat më të njohur të krijimeve të poetëve të rinj, prozatorëve që bënë emër në këto vite do të mbeten lëvruarit dhe modeluesit e parë të tipareve të reja të këtij hopi cilësor, pa varësisht se në të ardhmen këta emra e krijime të tyre do të jenë harruar.

3. Problematikat e poezisë së viteve '90

Në frymën e arsytimeve të mësipërme, nëse do të përiqeshim të ndërtonim konfiguracionin e prirjeve poetike të kohës, atëherë duhet të pranojmë, se pak a shumë do të kishim një tablo të tillë:

1. Poetë (shkrimtarë) tipikë të socrealizmit, që tani e tutje e ndejnë veten në pakicë e të anatemuar. Këtu grupohen sigurisht pseudoshkrimtarë e ish pseudopoetë me talent të pakët letrar, të cilët më vonë u investuan impozantë me letërsinë e tyre mediokre, dokumentare e memoaristike.

2. Poetë e shkrimtarë, si p.sh.: I. Kadare, D. Agolli, F. Arapi, Xh. Spahiu e të tjerë, të cilët për shkak të talentit të padiskutueshëm, përvojës letrare dhe famës së fituar, vijuan normalisht të punojnë, por duke vëzhguar e perceptuar veprimtarinë krijuese në realitete të reja politike-shoqërore e duke iu përshtatur pa sforcime horizonteve të reja estetike.

3. Poetë avangardë(istë), me moshë të re e koncepte kah moderniteti, që tentojnë "një grupim artisti që prodhon thyerje serioze me traditën" (Hatipi 2004). Është tepër i njohur në mjediset tona kulturore e letrare varianti estetik i këtij grupimi, i shpallur qysh në vitet e para të

demokracisë, për një poezi (letërsi) ndryshe, të lirë e moderniste. Ky grupim nisi si reagim estetik e ideologjik ndaj traditës letrare socrealiste, grumbulloi rreth vetes emra të tillë si: Mimoza Ahmeti, Rudian Zekthi, Ervin Hatibi, Virion Graçi, Agron Tufa, Romeo Çollaku, Arian Leka, Flurans Ilija, Luljeta Lleshanaku, Alket Cani. Ata vijnë ta ruajnë ende edhe sot këtë frymë, sidoqë rrjedha e kohës dhe trillet e saj, natyrshëm ofrojnë për ta sfida të panumërta e të gjith[farëlojshme.

4. Poetë e shkrimtarë të tjerë, të parreshtur në grupime apo organizime të tilla letrare, të tipit të avangardës, por që shkojnë drejt rrymës poetike moderne, që botojnë krijimtari, angazhohen në shtyp e marrin pjesë në jetën artistike të vendit.

5. Poetë e shkrimtarë të burgosur për shkaqe politike dhe estetike, të cilët nisën të integroheshin në jetën shoqërore e letrare të vendit. Kështu shkrimtarë e poetë të tillë, si Pjetër Arbnori, K. Trebeshina, Visar Zhiti, Uran Kostreci, Z. Pllumi hodhën në tregun letrar të kohës veprat e tyre (në prozë e poezi), të ideuara, të skicuara apo gjysmë të shkruara në qeli, si dhe vepra të frymëzuara nga realiteti i ri, me të cilin po përballëshin tani e tutje.

Letërsia (poezia) shqipe pas vitit 1990 është një proces në zhvillim. Shpeshherë elemente dhe komponenta të këtij procesi, natyrshëm ngjallin debate, diskutime, analiza e ndonjëherë edhe polemika. Në këtë pjesë të studimit do të vërejmë disa dukuri që u shfaqën në poezinë e viteve '90.

4. Diskutime dhe rezultate

Studiuesi Mark Maku, duke analizuar krijimtarinë letrare e sidomos atë poetike të viteve '90, mbërrin në një konkluzion të tillë: "Letërsia shqipe e viteve '90 lindi si një lëvizje avangardiste. Kur flas për letërsi të viteve '90 kam parasysh produktin kulturor të disa poetëve të rinj që u afirmuan në këto vite dhe jo produktin e gjithë periudhës. Më konkretisht këtu i referohem poezisë së Agron Tufës, Ervin Hatibit, Rudian Zekthit, Ilir Belliut, Rudi Erebarës, Gëzim Çoçolit. Poezitë e këtyre poetëve janë dukuri tipike e komponimeve metaforike dhe simbolike,

veçori për një pjesë të konsiderueshme autorësh" (Marku 2004: 129).

Tradita letrare vijon, letërsi e re prodhohet çdo ditë. "Të vjetrit" ndjekin kursin e tyre, idealet e tyre estetike, dikush në harmoni me kërkesat e kohës e dikush jo, ndërsa "të rinjtë" në veprat e tyre të para gjithsesi e kanë dëshmuar modernitetin dhe ekstravagancën novatore letrare, në gjuhë poetike, në forma të reja komunikimi, në "thyerjen" e disa normave të traditës, por ende nuk kanë mundur të krijojnë një konvencion të ri, të plotësuar, të dallueshëm poetik: ata vetëm sa e kanë përvijuar e konstituar atë.

Letërsia (poezia) e të rinjve, që i kanë fillat letrare në krye të viteve '90, ndodhet ende në mesin e itinerarit artistik. Duhet patjetër distanca e nevojshme kohore, që zakonisht, përputhet me mbylljen e ciklit artistik të një poeti, apo të një grupi letarësh, për të gjykuar rreth karakteristikave përfundimtare e thelbësore. Por nga ana tjetër kjo letërsi ka shumë nevojë për lexuesin e kultivuar dhe për studiuesin e fenomenit letrar. Lexuesi dhe studiuesi do të bëheshin kështu dëshmitarë të cilësive të reja pozitive avangardiste në letërsinë shqipe, sepse linden si shkatërrim i formave të mëparshme, si mohim total i letërsisë së realizmit socialist, si revoltë ideore, proceduese dhe gjuhësore.

Edhe pse "në fillimet e saj, ky mohim i traditës vjen si pohim i rrymave avangardiste të tejkaluara tashmë në letërsinë e mëdha të Evropës, ai u bë shkak i një thyerjeje të madhe në letërsinë shqipe" (Marku 2004: 129).

Për të kuptuar më mirë poezinë dhe poetët e avangardës, qëllimin dhe organizimin e tyre, evolucionin në rrjedhën e kohës, konceptet estetike, si dhe gjendjen e sotme të kësaj nisme e shohim të udhës t'i referohemi artikullit me titull "Në kërkim të avangardës" shkruar nga Ervin Hatibi, njëri prej ideatorëve të grupimit avangardist, ku autori portretizon diakronisht lëvizjen poetike e letrare avangardiste në Shqipërinë e pas vitit 1990. Mes të tjerash citojmë "Nëse avangardës do t'i rezervonim optikën më gjithëpërfshirëse, duke e përkufizuar thjesht dhe qartë si një grupim artistik që prodhon thyerje serioze me traditën, mbase në kushtet e shkrimit shqip do të

identifikonim më shumë se një të tillë /.../, nëse do të kërkonim procedurat administrative sipas modeleve të dy dekadave të para të shekullit të XX, kjo pastaj është pak si e pamundur për specifikat e mikroklimës shqiptare” (Hatipi 2004).

5. Prirjet avangardiste që u shfaqën

Padyshim, edhe arritja më cilësore në drejtim të asaj që e emëruam si modelim të tipareve të reja poetike përkon me ngritjen në shkallë të lartë të komunikimit të efekteve dhe të mesazheve poetike, të imazheve poetike përmes konteksteve të metaforikës dhe të simbolikës. Metaforika dhe simbolika e përmendur shihet të jenë realizuar në mënyrë të çrregullt. Megjithëse, një pjesë e mirë e kësaj poezie në pikëpamje të strukturës dhe të idesë poetike duket kapricioze, si ndaj mosrespektimit të rregullës metrike, ashtu edhe ndaj mosrespektimit të konteksteve logjike poetike. Prapësëpajë ajo sjell risi në shprehjen poetike, në ndërtimin e saj befasues, sjell risi në mënyrën se si këndvështrohet realiteti dhe qenësia njerëzore. Në këtë mes themi se është rritur ndjeshëm hapësira e përjetimit intim të poetëve, vëmendja dhe introspeksioni në gjendjet e mjegullta poetike, ku pluskojnë grimca gjenialiteti të mjegullta.

Karakteristikë e kësaj poezie është ajo që menjëherë bie në sy - shkurtimi i distancës mes poezisë dhe shpirtit njerëzor, tragjikës dhe komikes, duke bërë kështu të veten maksimën e njohur të Sokratit: “Njih vetveten pastaj të tjerët”. Këtë maksimë e kanë për temë mjaft vëllime poetike të kësaj kohe, të cilat ia mbajnë herë nga detaji grotesk i ironizimit me situatat e brendshme e të jashtme jetësore, herë nga theksimi i vuajtjes dhe i dhembjes shpirtërore të qënies, e cila gjithashtu e ka një fund, që sa kohë që qënia është në këtë botë, nuk është ai, sa kohë që është ai nuk është qënia.

Përjetimi poetik i këtyre autorëve shquhet për një ndjeshmëri shumë të lartë shqisore, perceptuese e receptuese, ajo është dyshuese, dyshim që e shtyn të depërtojë sa më në thellësi të dilemave që mendojnë botën. Shkalla cilësore e abstraksionit artistik si dhe pasuria e madhe leksikore janë një veçori tjetër e kësaj poezie.

Kjo poezi u shqua për një modelim të shpejtë të tipareve të reja poetike, ajo ruan në mënyrë të moderuar si preokupim filozofik angazhimin shoqëror, i cili më së shumti ka ardhur duke u sintetizuar si angazhim me problemet e brendshme të qenësisë njerëzore se sa si preokupim për temën e ditës dhe për problemet e vetëdijes së lartë shoqërore kolektivistike të mëparshme. Të bën përshtypje se kjo natyrë poezie nuk priret të përshkruajë tema nga realiteti i sotëm, por i mjafton shpirti njerëzor, i cili në të vërtetë është miniatura më komplekse e botës sonë.

Struktura dhe kuptimet e reja i interesojnë në veçati kësaj poezie dhe autorëve të saj. Një gjë e tillë vihet re në larminë e tipave ligjërimorë dhe në kontekstet poetologjike, që poetët i besojnë fjalës së tyre. I preferuar është vargu i lirë, me ritëm dhe rimë të brendshme, vargu i bardhë dhe më pak lëvrime i vargut të rregullt klasik. Prirja më e përgjithshme shihet të jetë ajo e vargut hermetik gjer edhe abuzimi me të, te ndonjë autor. Gjuha më komode, mbi të cilën ndërtohet shprehësia artistike, është gjuha e komponimeve metaforike dhe simbolike, veçori për një pjesë të konsiderueshme autorësh.

6. Konkluzione

Poezia e viteve të fundit është shquar për një modelim të shpejtë të tipareve të reja, duke iu larguar patosit kolektiv dhe përshkrimit të tematikave, të cilat nuk përshkruajnë thjesht të përditshmen, por hulumtojnë deri në thellësi të shpirtit njerëzor. Këtu do të theksohet arritja më cilësore në drejtim të shkallës së lartë të komunikimit të efekteve dhe mesazheve dhe imazheve poetike përmes konteksteve të metaforikës dhe simbolikës. Përjetimi i këtyre autorëve shquhet për një ndjeshmëri të lartë perceptuese e receptuese në të cilën gjejmë elemente të begata të jetës psikike individuale, po edhe shoqërore kombëtare. Shkalla cilësore e abstraksionit artistik dhe pasuria e madhe leksikore janë një veçori tjetër e kësaj poezie. Në përfundim do të ravijëzohen disa veçori thelbësore të kësaj poezie, te disa autorë të modeluar si të tillë, të afirmuar ose të paafirmuar

të cilët ndoshta kanë nevojë më shumë për lexuesin e kultivuar dhe për studiuesin e fenomenit letrar, të cilët janë dëshmia më e mirë e cilësive të reja pozitive.

Bibliografi

DADO, F. (2007), Si rrjedh letërsia e viteve '90: Mehr Licht, Tiranë, nr. 30.

HATIBI, E. (2004), Në kërkim të avangardës, www.Fajtori.com. maj.

MARKU, M. (2004), Fenomeni i avangardës në letërsinë shqipe, Tiranë.

(1996), Letërsia si e tillë, Akte të konferencës shkencore, Tiranë.

ELSIE, R. (2006), Letërsia shqipe, një histori e shkurtër, Tiranë..